

Nr.	Data e regjistrimit të kërkesës	Data e kthimit të përgjigjes	Kërkesa	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës
1	11.02.2026	11.02.2026	Informacion lidhur me numrin e klinikave estetike në Tiranë	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim tek Qendra Kombëtare e Biznesit.	E deleguar
2	11.02.2026	11.02.2026	Informacion lidhur me institucionin që lëshon licencat II.6.A.3 "Klinikë stomatologjike" dhe II.6.A.1 "Laborator dentar".	Përgjigje se referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.538, datë 26.05.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta” të ndryshuar, institucioni i cili shqyrton dhe merr vendim lidhur me licencat në fushën e shëndetësisë: II.6.A.3 "Klinikë stomatologjike" dhe II.6.A.1 "Laborator dentar" është Qendra Kombëtare e Biznesit.	E plotë
3	24.02.2026	02.03.2026	Informacion lidhur me punësimin në aparatin e MSHMS.	Përgjigje se punësimi për aparatin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale bëhet nëpërmjet portalit të Departamentit të Administratës Publike, ku parashikohen të gjitha elementët e kërkuara nga ana juaj. Për më shumë, mund të konsultoni linkun: Link .	E plotë

4	06.03.2026	09.03.2026	Informacion lidhur me kreditë e lehtësuara për blerjen e banesës.	Përgjigje se aplikimet për të përfituar nga trajtimi me kredi të lehtësuara për blerjen e banesës, fillojnë pas miratimit të kuotave për vitin 2026, nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave.	E plotë
5	09.03.2026	10.03.2026	Informacion lidhur me ndërtimin e godinës së parkimit në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit.	E deleguar
6	09.03.2026	12.03.2026	Informacion lidhur me Prekursorët e Drogës.	Përgjigje se Çertifikata e Regjistrimit për Importim, Eksportim, Ruajtje dhe Tregtim me Shumicë të Prekursorëve të Drogës të Kategorisë 3, e cila lëshohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për prekursorët e kategorisë 3, është e vlefshme kundrejt licencës profesionale dhe për aq kohë sa nuk tejkalohet sasia e deklaruar për import gjatë vitit kalendarik. Në rast të tejkalimit të sasive të deklaruara, duhet të paraqitet menjëherë kërkesë për rinovimin e çertifikatës. Kjo nënkupton se, nëse çertifikata është lëshuar në vitin 2025, sasia e miratuar për import i përket vitit kalendarik 2025.	E plotë

7	10.03.2026	13.03.2026	Informacion lidhur me reformën në sistemin spitalor.	Përgjigje se për pyetjet shteruese në lidhje me reformën në sistemin spitalor dhe njëkohësisht me forcimin e shërbimeve të kujdesit parësor, theksojmë se jemi ende në fazën e hartimit të draft-planit të reformës. Në qendër të objektivave tona mbetet vijueshmëria e shërbimeve cilësore për pacientët, si edhe mirëorganizimi i strukturave shëndetësore në nivel kombëtar. Në këtë fazë është ende herët për të dhënë përgjigje të detajuara ndaj pyetjeve tuaja në lidhje me drejtimet konkrete të kësaj reforme.	E plotë
8	19.03.2026	24.03.2026	Informacion lidhur me funksionimin e shërbimit të kardiokirurgjisë në QSUNT.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim tek Qendra Spitalore Univesitare “Nënë Tereza”.	E deleguar
9	26.03.2026	30.03.2026	Informacion lidhur me përfundimin e koncesionit “të sterilizimit të pajisjeve kirurgjikale”.	Përgjigje se pas përfundimit të kontratës koncesionare për shërbimin e sterilizimit të pajisjeve kirurgjikale, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 845, datë 30.12.2025, “Për krijimin e shoqërisë aksionare për ofrimin e shërbimit të integruar të sterilizimit”, funksionet dhe përgjegjësitë përkatëse janë transferuar nga modeli koncesionar në administrim publik, nëpërmjet një subjekti shtetëror të organizuar në formën e shoqërisë aksionare.	E plotë

10	09.04.2026	10.04.2026	Informacion lidhur me laboratorët biokimik dhe mikrobiologjik.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim tek Qendra Kombëtare e Biznesit.	E deleguar
11	10.04.2026	14.04.2026	Informacion lidhur me vulosjen e dokumentacionit pranë MSHMS.	Përgjigje se dokumentat për vulosje mund të sillen dorazi ose dërgohen me postë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, por normalisht që duke i sjellë dorazi perfundon më shpejt si procedurë, pasi eviton kohën që i nevojitet postës për t'i sjellë.	E plotë
12	23.04.2026	23.04.2026	Informacion lidhur me punësimin si infermier dhe dokumentacionin e nevojshëm.	Përgjigje se lidhur me dokumentacionin për ushtrimin e profesionit autoriteti kompentent është Urdhri i Infermierit në Republikën e Shqipërisë. Punësimi i personelit infermierë dhe i teknikëve të tjerë të shkencave mjekësore bëhet nëpërmjet Portalit “Infermierë për Shqipërinë”.	E plotë
13	25.04.2026	28.04.2026	Informacion lidhur me rrezikun e kontaminimit të produkteve ushqimore për bebe.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim tek Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.	E deleguar

14	27.04.2026	07.05.2026	Informacion lidhur me produktet ushqimore për foshnja të kompanisë HiPP në Shqipëri.	Përgjigje se deri në këtë moment, Instituti i Shëndetit Publik nuk ka pasur në dispozicion informacion zyrtar të transmetuar nga sistemet ndërkombëtare të njoftimit dhe shkëmbimit të informacionit për sigurinë ushqimore, përfshirë Sistemin Evropian të Njoftimit të Shpejtë për Ushqimin dhe Ushqimin për Kafshë (RASFF); Rrjetin ndërkombëtar INFOSAN, si dhe asnjë komunikim zyrtar nga institucionet përgjegjëse të Bashkimit Evropian apo nga institucioni kompetent kombëtar për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe menaxhimin e riskut (Autoriteti Kombëtar i Ushqimit , lidhur me importimin ose tregtimin në Shqipëri të produkteve të përmendura. Në mungesë të një informacioni të tillë zyrtar dhe të konfirmuar, nuk është kryer një vlerësim i rrezikut shëndetësor për popullatën foshnjore në Shqipëri. Për rrjedhojë, duke qenë se nuk ka të dhëna për ekspozim të popullatës foshnjore në Shqipëri ndaj këtyre produkteve, nuk janë ndërmarrë masa specifike apo dhënë udhëzime për institucionet përgjegjëse në vend. Gjithsesi, në kuadër të shqetësimeve të ngritura nga raportimet mediatike, Instituti i Shëndetit Publik ka kërkuar informacion shtesë dhe të detajuar për rastin. Nga shqyrtimi i informacionit të disponueshëm deri më tani, rezulton se produktet ushqimore për foshnja me rrezik për shëndetin janë tregtuar vetëm në Austri, Republikën Çeke dhe Sllovaki (1-6). Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Instituti i Shëndetit Publik mbeten të angazhuar për të ndjekur çdo informacion zyrtar që mund të vijë përmes kanaleve ndërkombëtare ose institucioneve kompetente kombëtare dhe, në rast se do të konfirmohet një rrezik real për shëndetin publik në Shqipëri, do të merren menjëherë masat përkatëse dhe do të informohet publiku në mënyrë transparente.	E plotë
----	------------	------------	--	---	---------

15	20.05.2026	25.05.2026	Informacion lidhur me Programin Kombëtar të Kontrollit Bazë “Check-up”.	Përgjigje se mbulimi Universal Shëndetësor është politikë kyçe e Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030, ku specifikohet ofrimi i shërbimeve shëndetësore cilësore dhe të barabarta për të gjithë popullsinë. Këto politika janë reflektuar në zbatimin e Programit Kombëtar të Kontrollit Bazë “Check-Up” dhe në heqjen e bashkëpagesave për vizitat në shërbimet shëndetësore, duke përmirësuar kështu aksesin në shërbimet e Kujdesit Shëndetësor Parësor (KSHP). Gjithashtu, ligji nr.10383, datë 24.02.2011, “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, mundëson vizita falas tek mjeku i familjes për të gjithë popullsinë rezidente në Shqipëri. Ky shërbim mbulon edhe individët e pasiguruar që kërkojnë konsultë me mjekun e familjes. Aktualisht, shërbimi i kontrollit mjekësor bazë (check-up) ofrohet për grupmoshat 35–70 vjeç, në përputhje me fashën e përcaktuar për përfitimin e këtij shërbimi. Politikat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale (MSHMS), në drejtim të programeve të parandalimit të sëmundjeve jo të transmetueshme, janë në proces të heqjes së kufirit maksimal të moshës për programin e Check-Up-it. Në këtë kuadër, programi pritet të funksionojë për të gjithë personat mbi moshën 35 vjeç. Vlen të theksohet që ky program është depistues në popullatë, pra i ofrohet popullatës së shëndoshë me qëllim identifikimin e parakohshëm të sëmundjeve jo të transmetueshme. Pranë institucioneve publike shëndetësore përkatëse, çdo qytetar pas konsultimit me mjekun, mund të kryejë setin e analizave të përshtatshme për gjëndjen e tyre shëndetësore.	E plotë
----	------------	------------	---	--	---------

16	22.05.2026	25.05.2026	Informacion lidhur me dokumentacionin për vulosje pranë MSHMS.	Përgjigje se dokumentet për vulosje mund të sillen dorazi ose dërgohen me postë, por normalisht që duke i sjellë dorazi perfundon më shpejt si procedurë, pasi eviton kohën që i nevojitet postës për t'i sjellë, në orarin E hënë – E enjte 08.00-16.30 E premte 08.00-14.00.	E plotë
17	02.06.2026	02.06.2026	Informacion lidhur me trajtimet e tjera financiare të punonjësve të sistemit shëndetësor.	Përgjigje se elementet përbërëse të pagës bruto mujore janë të përcaktuara në VKM nr. 424, datë 26.6.2024 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave e shtesave mbi pagë, kompensimeve dhe trajtimeve të tjera financiare të punonjësve të sistemit shëndetësor, në institucionet shëndetësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat shëndetësore të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar.	E plotë
18	02.06.2026	04.06.2026	Informacion lidhur me ndryshimet e ardhshme ligjore.	Përgjigje se në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian dhe në funksion të integritimit evropian, kuadri ligjor përkatës pritet t’i nënshtrohet ndryshimeve dhe përmirësimeve të mëtejshme.	E plotë

19	03.06.2026	04.06.2026	Informacion lidhur me mbulimin universal shëndetësor.	Përgjigje se Mbulimi Universal Shëndetësor është politikë kyçe e Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030, ku specifikohet ofrimi i shërbimeve shëndetësore cilësore dhe të barabarta për të gjithë popullsinë. Këto politika janë reflektuar në zbatimin e Programit Kombëtar të Kontrollit Bazë “Check-Up” dhe në heqjen e bashkëpagesave për vizitat në shërbimet shëndetësore, duke përmirësuar kështu aksesin në shërbimet e Kujdesit Shëndetësor Parësor (KSHP).	E plotë
20	07.06.2026	08.06.2026	Informacion lidhur me barin Edoxaban.	Përgjigje se Bari Edoxaban 30mg, 60mg, është në listën e barnave të ribursueshme e përshkruhet në recetën me rimbursim nga mjekët e përgjithshëm dhe të familjes	E plotë
21	08.06.2026	17.06.2026	Informacion lidhur me Ligjin nr. 10 454, datë 21.07.2011, “Për transplantimin e indeve, të qelizave dhe të organeve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.	Përgjigje se Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në zbatim të Ligjit nr. 10 454, datë 21.07.2011, “Për transplantimin e indeve, të qelizave dhe të organeve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 416, datë 11.12.2011, “Për miratimin e rregullores për procedurat e importimit dhe eksportimit të indeve, qelizave dhe organeve me origjinë njerëzore për qëllim transplanti”, lëshon autorizimet përkatëse për importin e indeve dhe qelizave me origjinë njerëzore, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në legjisllacionin në fuqi.	E plotë

22	13.06.2026	22.06.2026	Informacion lidhur mbi skemën e ndihmës ekonomike dhe numrin e përfituesve të kësaj skeme.	Përgjigje se në zbatim të Ligjit nr 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, përfituesit e ndihmës ekonomike janë: a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme; b) jetimët, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore; c) prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë; ç) viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre; d) viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore. Të dhënat mbi numrin e përfituese dhe sipas qarqeve e gjeni në linkun si më poshtë: https://www.sherbimisocial.gov.al/open-data/	E plotë
23	22.06.2026	23.06.2026	Informacion lidhur me godinën e Pediatriisë Infektive në QSUT.	Përgjigje se Projekt-preventivi për rikonstruksionin e godinës së Pediatriisë Infektive në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT) është hartuar në kuadër të projektit të financuar nga Banka Botërore për menaxhimin e pandemisë COVID-19, në muajin janar 2020. Lidhur me masat që po ndërmerren aktualisht nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ju informojmë se, QSUNT ka nisur procesin e hartimit të projekt-preventivit të zbatimit për ndërtimin e një godine të re të Pediatriisë Infektive.	E plotë

24	30.06.2026	30.06.2026	Informacion lidhur me shërbimin e ofruar nga një institucion shëndetësor.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim tek Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Vlorë.	E deleguar
25	01.07.2026	01.07.2026	Informacion lidhur me mallrat e përjashtuar nga TVSH.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim tek Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.	E deleguar
26	01.07.2026	01.07.2026	Informacion lidhur me ofrimin e shërbimit shëndetësor në Spitalin Rajonal Fier.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim tek Spitali Rajonal Fier.	E deleguar
27	06.07.2026	07.07.2026	Informacion lidhur me vendosjen në treg të produkteve biocide.	Përgjigje se informacioni gjendet duke konsultuar VKM nr. 933, datë 25.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg".	E plotë

28	07.07.2026	07.07.2026	Informacion lidhur me trajtimin financiar të punonjësve të institucioneve shtetërore.	Përgjigje se informacioni gjendet duke konsultuar VKM Nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit" të ndryshuar.	E plotë
29	07.07.2026	07.07.2026	Informacion lidhur me provimet e maturës shtetërore.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim tek Ministria e Arsimit.	E deleguar
30	08.07.2026	08.07.2026	Informacion lidhur me trajtimin me kredi të lehtësuar për blerjen e banesës.	Përgjigje se informacioni gjendet duke konsultuar Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 468, datë 26.7.2023 "Për trajtimin me kredi të lehtësuar të të punësuarve në administratën publike për blerjen e banesës".	E plotë

31	09.07.2026	10.07.2026	Informacion lidhur me ushtrimin e profesionit të teknikut imazherist.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim tek Urdhri i Infermierit në Republikën e Shqipërisë.	E deleguar
32	13.07.2026	13.07.2026	Informacion lidhur me mbulimin e shërbimit shëndetësor në Tiranë.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim tek Drejtoria Rajonale e Ofritit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Tiranë.	E deleguar
33	14.07.2026	15.07.2026	Informacion lidhur me vlefshmërinë kohore të dokumentit mjekësor “Vërtetim i aftë për punë”.	Përgjigje se informacioni gjendet duke konsultuar Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 639, datë 07.09.2016, "Për përcaktimin e rregullave, të procedurave dhe të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë", të ndryshuar.	E plotë

34	17.07.2026	17.07.2026	Informacion lidhur me shërbimin shëndetësor në Qendrën Spitalore Univesitare “Nënë Tereza”.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim tek Qendra Spitalore Univesitare “Nënë Tereza”.	E deleguar
35	20.07.2026	20.07.2026	Informacion lidhur me shërbimin shëndetësor në Qendrën Spitalore Univesitare “Nënë Tereza”.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim tek Qendra Spitalore Univesitare “Nënë Tereza”.	E deleguar
36	21.07.2026	21.07.2026	Informacion lidhur me përfitimin e Kemp-it.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim tek Shërbimi Social Shtetëror.	E deleguar

37	23.07.2026	23.07.2026	Informacion lidhur me shërbimin shëndetësor për shtetasit e huaj në Republikën e Shqipërisë.	Informacion se Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) ushtron veprimtarinë e tij në zbatim të ligjit nr. 10 383, datë 24.02.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 05.03.2014, "Për miratimin e Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Në këtë kuadër, FSDKSH administron dhe financon shërbimet e kujdesit shëndetësor në zbatim të skemës së sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor. Për shtetasit e huaj me leje qëndrimi të përhershme ose të përkohshme, regjistrimi në skemën e sigurimit shëndetësor kryhet pranë Drejtorive Rajonale/Degëve të FSDKSH, duke plotësuar formularin tip "Kërkesë për regjistrim/përditësim personi" dhe duke paraqitur lejen e qëndrimit të vlefshme të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse ose kartën biometrike (FID). Gjithashtu, shtetasit e huaj dhe familjarët e tyre kanë të drejtë të bashkohen vullnetarisht me skemën e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor. Personat e siguruar vullnetarisht gëzojnë të njëjtat të drejta dhe kanë të njëjtat detyrime si personat subjekt i sigurimit të detyrueshëm, me kusht që të plotësojnë periudhën pritëse 6-mujore, e cila llogaritet nga data e regjistrimit dhe e pagesës së kontributit deri në datën e lindjes së së drejtës për përfitim.	E plotë
----	------------	------------	---	---	---------

38	24.07.2026	24.07.2026	Informacion lidhur me përfitimin e Kemp-it.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim tek Shërbimi Social Shtetëror.	E deleguar
39	24.07.2026	24.07.2026	Informacion lidhur me trajtimin me kredi të lehtësuar për blerjen e banesës.	Përgjigje se për hapjen e procesit të aplikimeve për përfitimin nga programi i trajtimit me kredi të lehtësuar për blerjen e banesës, do të publikohet njoftimi përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	E plotë
40	24.07.2026	27.07.2026	Informacion lidhur me Aktin Normativ nr. 2, datë 30.06.2026.	Përgjigje se me Aktin Normativ nr. 2, datë 30.06.2026, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, buxheti i MSHMS për vitin 2026 u rrit në vlerën 113,040,925 mijë lekë.	E plotë

41	27.07.2026	27.07.2026	Informacion lidhur me shërbimin shëndetësor në Spitalin Rajonal Vlorë.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim tek Spitali Rajonal Vlorë.	E deleguar
42	27.07.2026	27.07.2026	Informacion lidhur me alokimin e fondeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.	Përgjigje se Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka transferuar fondet përkatëse për ekzekutim.	E plotë
43	28.07.2026	28.07.2026	Informacion lidhur me insitucionet shëndetësore publike.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim tek Drejtoria Qendrore e Ofritit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor	E deleguar